

Titulli i lëndës: GJUHË TURKE 5

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë - Dega e Orientalistikës
Titulli i lëndës:	Gjuhë Turke 5
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Lënda zgjedhore
Viti i studimeve:	VII
Numri i orëve në javë:	1+2
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	Prishtinë
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Zeqije Xhafçe
Të dhënat kontaktuese:	Zekije.xhafqe@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Gjuhë Turke V është vazhdimi i lëndës Gjuhë turke IV ku do të vazhdojë të mësohet gjuha turke në nivelin B1. Kjo lëndë përbëhet nga praktikumi i gjuhës turke në situata të ndryshme nëpërmjetë bisedimit dhe shkrimit. Nëpërmjetë temave të ndryshme siç janë kinematografia, mitologjia, festat dhe festivalet botërore, psikologjia e njeriut etj. do të ushtrohen kompetencat e dëgjimit, leximit, të folurit dhe të shkruarit. Do të mësojnë si të zhvillojnë biseda në situata të jashtëzakonshme si dhe do të kompozojnë tekste duke i zbatuar rregullat gramatikore të gjuhës standarde turke. Nga temat gramatikore do të mësojnë si t'i zbatojnë pjesoret dhe sipjesoret, format e pashtjelluara duke i zbatuar me prapashtesat pronësore</p>

Qëllimet e lëndës:

- të përsosin të folurit në nivele më të larta intelektuale,
- të përsosin aftësinë e të dëgjuarit, përmes mjeteve auditive dhe kolegëve të tyre,
- të zotërojnë edhe më shumë aftësitë e të folurit në situatat të ndryshme,
- të zgjerojnë fjalorin dhe shkathtësitë e të shkruarit formal në gjuhën turke.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti :

Përvetëson njësi të reja gramatikore siç janë përdorimi i foljeve në mënyrën dëshirore dhe kushtore duke bërë krahasimin me mënyrën lidhore të gjuhës shqipe.

Kupton biseda të zhvilluara në situata të ndryshme si dhe tekstet që i dëgjon, nxjerr konkludime, kërkon raportin e shkakut dhe pasojës midis ngjarjeve të tregimit

Shkruan letra, dokumente dhe e-maila shokëve dhe të afërmeve të tij për të kërkuar informacione në lidhje me shkaqet, zhvillimet dhe rezultatet e ngjarjeve

Komponon tekste ku i thekson pikat më të rëndësishme të ngjarjeve dhe eksperiencave që i përjeton

Zbaton ligjeratën e drejtë dhe të zhdrejtë në tekste të shkruara dhe gjatë bisedës

Vlerëson ngjarje dhe koncepte, shpreh mendimin dhe ndjenjat e tij dhe i diskuton mendimet e të tjerëve

mëson thënie, fjalë me kuptime figurative

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike	10 min	15	2.5

Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	40 min	7	4.6
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	10	2	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	30 min	1	0.5
Total			98.1 orë 95.6/25=3.96 4 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	<p>Gjuhë Turke V është mësim i rregullt dhe mësimi mbahet në mënyrë grupore dhe 1+2 orë në javë. Forma e ligjerimit është praktike dhe interaktive. Pjesa teorike përbënë 25% ndërsa pjesa praktike 75% të lëndës. Organizohen vizitat në qendrat kulturore turke, merret pjesë në seminare të ndryshme letrare, gjuhësore etj.</p> <p>Metodat e zbatuara gjatë ligjeratës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Metoda e garamatikës-përkthimit, - metoda direkte e cila bazohet në dialogje ose tregime të shkurtra me të cilët tërhiqet interesi i studenteve dhe e cila bazohet në dëgjim, lexim, kuptim dhe bised, - metoda e bazuar në detyra, - metoda audio-linguale, - metoda audiovisuale, - metoda komunikative dhe eklektike.
Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%.</p> <p>Vijueshmëria e studentit 10%;</p> <p>Kollokviumi 30%</p> <p>Provimi final 60%.</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Yeni İklim Türkçe B1 Ders Kitabı, Yunus Emre Enstitüsü Türkçe Öğretim Seti , z- kitap 2. Suer Eker, Çağdas Türk Dili, 11. Baskı, Ankara: Grafiker Yayınları, 2009 4. Mehdi Polisi, Gramatika e Gjuhës Turke, Logos, Prishtinë, 2002

Literatura shtesë:

1. *Jaklin Kornfilt, Turkish Grammar (Descriptive Grammar), Routledge, London, 1997.*
2. *Veprat klasike dhe bashkëkohore letrare turke*

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	<i>Bota e kafsheve</i> Participet : -(y)en, -(y)ecek, -mekte, -miş olan
Java 2:	<i>Nëna natyrë</i> Participet: -dik/(y)ecek, + p.pronësore -(y)ecek/-mekte/--miş ol + -duk+ p.pronësore
Java 3:	<i>Ç' kemi bërë?</i> Participet (fjalorë) : -(e/ir/-mez/-dik/(y)ecek/-miş
Java 4:	<i>Bota e Kinemasë</i> Format e pashtjelluara: -dik/-ecek/+p.pronësore -(y)ecek,-mekte/-miş ol + -duk + p.pronësore
Java 5:	<i>Filmi si pasion dhe çmimet e rëndësishme të kinematografisë botërore</i> Format e pashtjelluara: -dik/-ecek +p.pronësore sirada, -(y)ince, -(e/i)r -mez
Java 6:	<i>Të paharrueshmit</i> Format e pashtjelluara të foljeve: -(y)ene/-(y)inceye, kadar/dek
Java 7:	Kollokvium (1 orë) <i>Mitologji</i> Ligjerata e zhdrejtë (të gjitha kohët)
Java 8:	<i>Shembuj nga mitologjia botërore: Dashuria e Erosit</i> Ligjerata e zhdrejtë : -dik/-ecek +p.pronësore + -(n)i söyle
Java 9:	<i>Bestytnitë</i> Ligjerata e zhdrejtë: (Pyetjet me PO dhe JO) -(y)ip.. -me + -dik/-ecek + p.pronësore + -(n)i sor-
Java 10:	<i>Ngjarjet Misterioze: Fshehtësitë e Anadollit, Pse u fundos Titaniku</i> Ligjerata e Zhdrejtë (fjalja emërore) (olup) ...ol(-ma) + -dik +p.pronësore +-(n)i
Java 11:	<i>Festat</i> Format e pashtjelluara të foljeve: -dik/-(y)ecek + p.pronësore için, -dik/-ecek + -(n)den
Java 12:	<i>Festivalet botërore</i> Nominalizimi: -me/-dik/-(y)ecek +p.pronësore + -(n)e/-(n)de/-(n)den/-(n)i
Java 13:	<i>Njeriu: Psikologjia e njeriut, Karakteret njerëzore</i> Format e pashtjelluara: -dik/-(y)ecek + p.pronësore halde

Java 14:	<i>Jeta dhe Standardet: Margjinaliteti, Mençuria dhe Çmenduria</i> Pasfjalët që shprehin kundërshtim: <i>-(y)e rağmen/karşın, -se de/bile</i>
Java 15:	Kolokvium

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Për të pasur sukses më të mirë dhe më të lehtë në përvetësimin e lëndës janë disa kërkesa që duhet t'u përmbahet studenti. Të gjitha ato mund të përfshihen shkurt: vijimi i rregullt i mësimit; interesimi dhe angazhimi i tij për ta përvetësuar lëndën; sjellja e mirë dhe korrekte; respektimi i mendimeve; ndihma reciproke etj. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.